



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 04.03.2023
Nr. 8/9/10 Prot.

**FTESË PËR NEGOCIATË PËR: AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E
MEDIAVE VIZIVE PËR TRANSMETIMIN NGA OPERATORËT TELEVIZIVË TË
FUSHATËS EDUKUESE, INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE (SPOTE) NË
KUADËR TË ZGJEDHJEVE TË QEVERISJES VENDORE TË 14 MAJIT 2023.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 1/b, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të VKM-së Nr.1195, datë 05.08.2008 "Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve ose reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohën e transmetimit, nga organet e administratës shtetërore" dhe Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 220 datë 07.12.2022 "Për miratimin e Programit të Edukimit, Informimit dhe Ndërgjegjësimit të Zgjedhësve, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të realizojë "transmetimin e videove/spoteve edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese" për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023.

OBJEKTI

"Transmetimin e videove (spote) në kuadër të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për procesin zgjedhor të 14 majit 2023.

Periudha e realizimit: 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.



Fondi limit i përcaktuar për transmetimin në televizione: Fondi limit i procedurës është në vlerën 72,000,000 (shtatëdhjetë e dy milionë) **lekë me Tvsh.**

Afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit nga televizionet është më datë 04.03.2023) ora 16:00 nga momenti i publikimit dhe dërgimit të ftesave.

Dokumentacioni/ofertat duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe jo përpara datës **04.03.2023, ora 16.00.**

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht jeni të lutur t'i paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr 4
Adresa e Internetit: www.kqz.gov.al

Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Transmetimin e videove (spoteve) edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuere" kriteret do të jenë si më poshtë.

Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

1. TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi i kësaj fushate është: Informimi, Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve në të gjithë Shqipërinë, me qëllimin final për t'u ardhur në ndihmë të gjithë zgjedhësve, që të informohen për hapat e procesit zgjedhor, kërkimin e emrit në listat e zgjedhësve, dokumentet që duhen në ditën e zgjedhjeve, mënyrën e plotësimit të fletës së votimit, krimet zgjedhore, identifikimin dhe votimin elektronik, e të tjera, jo vetëm në një zonë të caktuar, por në të gjithë vendin.

Përshkrimi:

Transmetimin e videove (spote) në kuadër të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për Zgjedhjet e Qeverisjes Vendore të 14 majit 2023.

Videot/spotet përmbajnë në fokus informacionin e plotë dhe të detajuar për procesin zgjedhor të datës 14 maj 2023.

Videot/spotet duhet të transmetohen në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve dhe në formatin Full HD.

Shërbimet që kërkohen të realizohen:

Transmetimi i videove/spoteve duhet të ketë përmbajtjen e qëllimit të vendosur në këtë ftesë për negociatë, sipas kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke përfshirë të gjitha kategoritë e zgjedhësve.

Karakteristikat:

- Kohëzgjatja e videove (spote) mesatarisht 45 - 60 sekonda.
- Transmetimi full HD.
- Kualiteti 4K.
- Videot informuese janë shoqëruar nga një seri imazhesh statike me mesazh zgjedhor.
- Videot janë të përshtatura në gjuhën e shenjave.
- Videot janë të përshtatura me titra në gjuhën e pakicave që jetojnë në Shqipëri, përkatësisht në 8 gjuhë (greke, malazeze, bullgare, serbe, rome, maqedonase, arumune dhe boshnjake).



Për transmetimin e videove/spoteve është marrë në konsideratë

- Analiza e zgjedhjeve të kaluara, vlerësimi i targetgrupeve, nevojat për informacion kryesisht tek të rinjtë që votojnë për herë të parë, gratë, romët, personat me aftësi ndryshe e të tjerë, si dhe hulumtime të thelluara të informacionit publik në dispozicion.

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimet e përcaktuara më lart në funksion të objektit Transmetimi i videove/spote në kuadër të Zgjedhjeve Vendore të 14 majit.

Spotet janë realizuar me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve me kualitet 4K dhe Full HD.

Pamjet janë ekskluzive.

Efektet audio dhe efektet muzikore në përmbajtje të materialit përfundimtar janë trajtuar posaçërisht për spotin televiziv dhe zotërohen të gjitha të drejtat e rezervuara të përdorimit të pakufizuar si në aspektin gjeografik ashtu edhe në aspektin kohor.

Videot/spotet përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe website zyrtar të KQZ.

2. INFORMACION DHE KËRKESA SPECIFIKE NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK KRITERET E PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kriteret e përgjithshme:

Dokumentacioni ligjor që duhet paraqitur për të plotësuar kriteret kualifikuese:

- a) Ekstrakti i shoqërisë, që është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm.
- b) Nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) Vërtetim që nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

- d) Vërtetim që nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- e) Deklaratë që nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) Deklaratë që ka paraqitur një ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- g) Deklaratë që kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Kriteret e përgjithshme financiare, kapaciteti financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të certifikuar të bilancit për periudhën e vitit 2022, të deklaruara pranë autoriteteve përkatëse tatimore. (më mirë vërtetim xhiro 1 ose 2 vitet e fundit).

Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit për negociata, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% të fondit të parashikuar për këtë shërbim. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:
 - *Për kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
 - *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
2. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, me të cilën merr përsipër se ka kapacitetet e nevojshme për të siguruar transmetimin e videove (spote).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e publikimit të njoftimit për negociata. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës dhe sipas specifikimeve në Ftesën për Ofertë.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr.1195 datë 05.08.2008.

3. KRITERET E VLERËSIMIT

- **Kriteret e përgjithshme: 10**
- **Kapaciteti financiar:10**
- **Kapaciteti teknik dhe profesional 30**
- **Oferta financiare e shoqëruar me projektpropozimin për transmetim të videove/spoteve 50**

Vlerësohet me 30 pikë dokumentacioni ligjor i paraqitur

Vlerësohet me 20 pikë eksperiencia e mëparshme e operatorit ekonomik

Vlerësohet me 50 pikë çmimi i ofruar nga media televizive.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë, e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negocim.

